



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKAKOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|--|-------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranimat / Detezuar Punime/Prodatur Rrezeve/ Detyruesh | 12.04.2023 | 3 | viti god veq |
| Organ /Njesia Organi /Jedimica Org. Unit | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. | Shlojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMS/ICK | 3501/2023 | | 1/4 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.432/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malësore Gashi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.432/2023 të datës 28.02.2023 të parashtruar nga ankuesja _____, nga Prishtina, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 12.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Refuzohet si e pa bazuar* ankesa A.nr.432/2023 e datës 28.02.2023, e parashtruar nga ankuesja _____
- II. *Mbetet në fuqi* Formulari i datës 27.01.2023, për vlerësimin e rezultateve në punës për vitin 2022 për ankuesen.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile _____ e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 28.02.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, me pretendimin për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa, Këshilli me datë 10.03.2023 ka pranuar vetëm shkresat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2153/2023 të datës 28.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 27.01.2023 i nënshkruar nga ankuesja më datë 29.01.2023; Emailin e datës 29.01.2023 nga ankuesja për F.A; Emailin e datës 28.01.2023 nga F.A për ankuesen; Komentet për vlerësim për vitin 2022 nga ankuesja për mbikëqyrësin e drejtpërdrejt; Emailin e datës 30.01.2023 nga ankuesja për F.A; Emailin e datës 25.02.2023 nga ankuesja për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2402/2023 e datës 06.03.2023; Përgjigjen në anesë me numër protokolli 2552/2023 e datës 10.03.2023; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm i vitit 2021, 2020, 2019; Vendimin Nr. Ref: 630/2018 i datës 23.07.2018; Vendimin me Nr. Ref: 453/2022 i datës 13.07.2022; Vendimin me Nr. Ref: 157/202 i datës 18.03.2022; Emailin e datës 11.03.2023 nga F.A për V.B; Emailin e datës 10.03.2023 nga Konsullata e Republikës së Kosovës në Berlin për F.A; Emailin e datës 10.03.2023 nga B.K për F.A; Emailin e datës 25.01.2023 nga ankuesja për F.A; Emailin e datës 25.01.2023 nga F.A për ankuesen; Emailin e datës 25.01.2023 nga A.M për Ambasadën në Gjermani; Emailin e datës 23.02.2023 nga F.A për ankuesen; Emailin e datës 26.08.2022 nga ankuesja për F.A; Emailin e datës 26.08.2022 nga F.A për ankuesen; Emailin e datës 21.04.2022 nga F.A për ankuesen; Emailin e datës 18.11.2021, 17.11.2021 nga ankuesja për F.A; Emailin e datës 22.09.2021 nga ankuesja për V.O; Emailin e datës 20.09.2021 nga V.O për I.LI; dhe ankuesen; Emailin e datës 05.09.2022 nga ankuesja për B.I; Emailin e datës 02.09.2022 nga F.A për V.B; Shkresë e datës 18.11.2021 nga ankuesja; Shkresë për arsyetim të mungesës në punë nga ankuesja e datës 05.09.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe se e njëjta sipas vendimit Nr.Ref:157/2022 të datës 21.03.2022 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është caktuar Udhëheqëse e Konsullatës së Republikës së Kosovës në Shtutgart/Gjermani duke filluar nga data 21.03.2022, kurse më Vendimin Nr.ref 453/2022 të datës 13.07.2022 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankueses i është vazhduar mandati i Udhëheqëses së Konsullatës së Republikës së Kosovës në Shtutgart/Gjerman deri deri më 31.07.2023.

Me tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së Ambasadori i Republikës së Kosovës në Gjermani, në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt të ankueses, me datë 27.01.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022, me notë të përgjithshme 3.8.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vlerësimit të rezultateve në punë sipas Formularit të datës 27.01.2023,

pretendon se më rastin e vlerësimit të rezultateve në punë janë shkelur dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike sepse nuk ka pasur takime për të diskutuar realizimin e objektivave.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji mori parasysh dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit..... dhe nenin 5 paragrafin 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar), rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës rezulton së ankuesja për periudhën e parë të vitit 2022 lidhur me pjesën e përmbushjes dhe realizimit të objektivave të punës është vlerësuar më notë 4, ndërsa lidhur me pjesën e aftësive dhe shkathtësive profesionale është vlerësuar më notë 3.5, ku gjithsej nota e përgjithshme për këtë periudhë është 3.8.*


Andaj, në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 në paragrafi 1.4 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, nota përfundimtare e vlerësimit nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë", përkatësisht "shumë mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit, kështu që mbi këtë bazë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me vendosjen e notës së përgjithshme 3.8 ka vlerësuar së ankuesja ka përmbushur dhe realizuar të gjitha objektivat e punës dhe së e njëjta ka tejkaluar pritjet sipas këtyre objektivave.


Lidhur me pretendimin së me rastin e vlerësimit të ankueses për vitin 2022 janë shkelur dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike sepse nuk ka pasur takime për të diskutuar realizimin e objektivave, Kolegji nga shqyrtimi i provave të lëndës ka konstatuar së mbikëqyrësi i drejtpërdrejt më datë 28.01.2023 ka përcjell tek ankuesja Formularin e vlerësimit të në punë për vitin 2022, ndërsa organizimi i takimit me ankuesen ka qenë i pamundur për shkak të distancës fizike, rrjedhimisht mbikëqyrësi i ankueses është me lokacion të punës në Berlin/Gjermani, kurse ankuesja në Shtutgart/Gjermani, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk qëndron .

Nisur nga faktet si me lart, Kolegji i Këshillit konstaton së vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, kështu që në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.432/2023

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPJD-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

